



REPUBLIKA E KOSOVËS
QENDRA KRYESORE E MJEKËSISË FAMILJARE
Rr. Fehmi Agani” nr.22 – Prishtinë
P R I S H T I N Ë

Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare në Prishtinë , në përputhje me nenin 8, të Ligjit të punës nr. 03/L- 212 , Nenit 14. par.2. të Ligjit për Shëndetësi Nr.04/L125, nenit 3, të Udhëzimit Administrativ nr. 07/2017 Për rregullimin e procedurave për themelimin e marrëdhënies së punës në sektorin publik, dhe vendimit nr.118 të dt. 11.01.2018 të Këshillit Drejtues të QKMF-ës, publikon këtë :

K O N K U R S
Për pranim në marrëdhënie pune

I.TITULLI I VENDIT TË PUNËS: Specialist i Mjekësisë Familjare në Qendrën Kryesore të Mjekësisë Familjare pesë (5) pozita

Kategoria dhe grada e vendit të punës:

- Koeficienti: 8,40, H-27
- Orari: 40 orë në javë,
- Kohëzgjatja e emërimit : Sipas Ligjit të punës nr. 03/L-212.

Detyrat dhe përgjegjësitë:

Bënë ekzaminimin fizikë (inspektimin ,auskultimin ,palpimin, perkutimin),përdorë mjetet e punës (stetoskopin,tensimetrin ,otoskopin ,oftalmoskopin,EKG..)vendos diagnozën e punës ,referon për analiza ,hulumtime diagnostiko dhe konsulta specialistike ,këshillon pacientin,cakton terminin për vizitën e ardhshme dhe e plotëson kartelën shëndetësore. Bënë promovimin shëndetësor ,parandalimin , diagnostifikimin ,mjekimin dhe rehabilitimin e sëmundjeve ,çrregullimeve dhe lëndimeve .Ofron shërbime të kujdesit shëndetësor për nëna dhe fëmijë. Ofron shërbime të shëndetit riprodhues duke e përfshirë edhe planifikimin familjar .Kryen edhe punë të tjera sipas sistematizimit të vendit të punës. Për punën e vet i përgjigjet shefit.

Kushtet e Konkursit:

Kandidati/ja të cilët konkurrojnë për këtë vend të punës përveç kushteve të përgjithshme të parapara me Ligj duhet të ketë të përfunduar :

- Fakultetin e Mjekësisë dhe Specializimin nga Mjekësia Familjare
- Kandidati/ja duhet të ketë Licencën e Punës.

Dokumentet e kërkuara:

- Kopjet e diplomës së Fakultetit të Mjekësisë, dhe Certifikatën e specializimit,
- Kopjen e licencës së punës
- Kopjen e letërnjoftimit apo të pasaportës
- Çdo dokument tjetër apo certifikatë trajnimi , që kandidati/ja e vlerëson të nevojshme që i përshtatet kushteve dhe kriterëve të përcaktuara më lartë.
- Dëshmi mbi njohjen bazike e punës me kompjuter; - e dëshirueshme.

II. TITULLI I VENDIT TË PUNËS: Tetë (8) infermiere të përgjithshme në Qendrën Kryesore të Mjekësisë Familjare

- Kategoria dhe grada e vendit të punës:
- Koeficienti – 4.80,- H-68
- Orari: - 40 orë në javë
- Kohëzgjatja e emërimit: Sipas Ligjit të punës nr. 03/L-212

Detyrat dhe përgjegjësitë:

Pranon triazhon dhe informon pacientin hap kartelën shëndetësore dhe merr anamnezën orientuese, aplikon terapinë parenteriale, i.m.i.v. sub kutan, aplikon infuzionet , bënë inhalimin , përpunimin e plagës, përcjellë kalendarin e imunizimit aplikon në dhënien e oksigjenit, bënë audiogramet e nevojshme etj.Kryen edhe punë të tjera sipas sistematizimit të vendit të punës. Për punën e vet i përgjigjet shefit të shërbimit dhe infermieres përgjegjëse.

Kushtet e konkursit:

Kandidati/ja të cilët konkurrojnë për këtë vend të punës përveç kushteve të përgjithshme të parapara me Ligj duhet të ketë të përfunduar :

- Bachellor, - Dega infermieri e përgjithshme;
- Shkollën e mesme të mjekësisë - Drejtimi i përgjithshëm
- Kandidati/ja duhet të ketë Licencën e Punës.

Dokumentet e kërkuara:

- Kopjet e diplomës së shkollimit të kryer
- Kopjen e licencës së punës
- Kopjen e letërnjoftimit apo të pasaportës
- Çdo dokument tjetër apo certifikatë trajnimi që kandidati/ja e vlerëson të nevojshme që i përshtatet kushteve dhe kriterëve të përcaktuara më lartë.
- Dëshmi mbi njohjen bazike të punës me kompjuter; - e dëshirueshme

III.TITULLI I VENDIT TË PUNËS: Doktor të Stomatologjisë në Qendrën Kryesore të Mjekësisë Familjare Dy (2) pozita

Kategoria dhe grada e vendit të punës

- Koeficienti 7.20 -H – 26,
- Orari i: 40 orë në javë
- Kohëzgjatja e emërimit: - Sipas Ligjit të punës nr. 03/L-2012

Detyrat dhe përgjegjësitë:

Bën promovimin dhe edukimin mbi shëndetin oral,bën parandalimin e sëmundjeve të gojës dhe dhëmbit,shëron dhëmbët karioz ,bën florizimin e dhëmbëve te fëmijët ,ofron ndihmën e parë stomatologjike ,kryen nxjerrjen e dhëmbëve ,referon pacientin për vazhdim trajtimin te mjeku specialist .Kryen edhe punë të tjera sipas sistematizimit të vendit të punës . Për punën e vet i përgjigjet shefit.

Kushtet e konkursit:

Kandidati/ja të cilët konkurrojnë për këtë vend të punës përveç kushteve të përgjithshme të parapara me Ligj duhet të ketë të përfunduar :

- Fakultetin e Mjekësisë - Drejtimi i Stomatologjisë
- Kandidati/ ja duhet të ketë Licencën e Punës.

Dokumentet e kërkuara:

- Kopjet e diplomës së Fakultetit të Mjekësisë,

- Kopjen e licencës së punës
- Kopjen e letërnjoftimit apo të pasaportës
- Çdo dokument tjetër apo certifikatë trajnimi , që kandidati/ja e vlerëson të nevojshme që i përshtatet kushteve dhe kritereve të përcaktuara më lartë.
- Dëshmi mbi njohjen bazike të punës me kompjuter; - e dëshirueshme,

IV . TITULLI I VENDIT TË PUNËS: Ass.Stomatologjisë në Qendrën Kryesore të Mjekësisë Familjare Pesë (5) pozita

Kategoria dhe grada e vendit të punës

- Koeficienti 4.80 -H – 68,
- Orari i: 40 orë në javë
- Kohëzgjatja e emërimit: - Sipas Ligjit të punës nr. 03/L-2012

Detyrat dhe përgjegjësitë:

Vendos kontaktin e parë me pacientin ,evidenton të dhënat e nevojshme mjekësore .E përgatit dhe e mirëmban aparaturën stomatologjike ,instrumentet dhe mjetet tjera për punë. Bashkëpunon me mjekun stomatolog dhe i ndihmon në të gjitha ndërmarrjet stomatologjike ,koordinon punën dhe bashkëpunon me teknikët e dhëmbëve .Kryen edhe punë të tjera sipas sistematizimit të vendit të punës. Për punën e vet i përgjigjet shefit dhe infermieres përgjegjëse.

Kushtet e konkursit:

Kandidati/ja të cilët konkurrojnë për këtë vend të punës përveç kushteve të përgjithshme të parapara me Ligj duhet të ketë të përfunduar :

- Shkollën e mesme të mjekësisë - Drejtimet stomatologjike.
- Kandidati/ja duhet të ketë Licencën e Punës.

Dokumentet e kërkuara:

- Kopjet e diplomës së shkollimit të kryer
- Kopjen e licencës së punës
- Kopjen e letërnjoftimit apo të pasaportës
- Çdo dokument tjetër apo certifikatë trajnimi që kandidati/ja e vlerëson të nevojshme që i përshtatet kushteve dhe kritereve të përcaktuara më lartë.
- Dëshmi mbi njohjen bazike të punës me kompjuter; - e dëshirueshme

V. TITULLI I VENDIT TË PUNËS: Higjienist në Qendrën Kryesore të Mjekësisë Familjare Dy (2) pozita

Kategoria dhe grada e vendit të punës

- Koeficienti 4.00 -H – 74,
- Orari i: 40 orë në javë
- Kohëzgjatja e emërimit: - Sipas Ligjit të punës nr. 03/L-2012

Detyrat dhe përgjegjësitë:

Bën pastrimin e dyerve dhe dritareve, dyshemesë, korridoreve, mureve respektivisht bën pastrimin e të gjitha lokaleve për të cilin është caktuar me përjashtim të instrumenteve mjekësore të cilat i pastrojnë infermieret, bën pastrimin e lavamanit.Kryen dhe punë tjera nga lëmia e tij përkatëse në bazë të urdhërësës të kryeinfermieres dhe shefit të shërbimit. Për punën e vet i përgjigjet shefit të shërbimit dhe kryeinfermieres.

Dokumentet e kërkuara:

- Shkollimi i kryer
- Kopjen e letërnjoftimit apo të pasaportës

Data e shpalljes së Konkursit 12.01.2018 deri më dt.26.01.2018.

Aplikacioni merren dhe dorëzohet në Administratën e QKMF-ës, (nga ora 8-15)

Rruga "Fehmi Agani" nr.22 – Prishtinë.

Dokumentacioni i cili i bashkëngjitet aplikacionit duhet të jetë kopje dhe i njëjti nuk kthehet.

Dokumentacioni i cili nuk i u përgjigjet kërkesave dhe specifikave të konkursit si dhe dokumentacioni i pa kompletuar dhe ai që mbërrin me vonesë nuk do të shqyrtohen.